



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 100, datë 05.10.2018

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "CITRUS" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike, për *mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje kompjutera për administratën e Bashkisë" me vlerë 773.000 lekë pa tvsh, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "CITRUS" Shpk me NIPT L41519004V, me adresë: Rruga "Fortuzi", Pallati Nr.134, kati I-rë, Tiranë.

II. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "CITRUS" Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 4525 Prot., datë 05.07.2018 të dërguar nga Bashkia Berat, me të cilën kjo e fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "CITRUS" Shpk, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/ç të LPP.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e *mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr. 100, datë 05.10.2018 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për 1 (një) vit operatorin ekonomik "CITRUS" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, *nga hyrja në fuqi e këtij vendimi*, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që, operatori ekonomik "CITRUS" Shpk nuk ka precedentë të mëparshëm për përjashtim nga pjesëmarrja në prokurimet publike, procedura e prokurimit është me vlerë të vogël, si dhe faktin se pajisjet objekt prokurimi janë lëvruar.